






REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot Br Prot Prot No <u>01-2662/14</u>
Nr. 1 faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>18-07-2014</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18/07/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Besim TAHIRI Menaxher Prokurimi – Prokurori i Shtetit
CC:	z. Shkëlzen MALIQI Drejtor Ekzekutiv – Prokurori i Shtetit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit



I nderuari z. TAHIRI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit” me numër prokurimi: PSH-250-140-12-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit” me numër prokurimi: PSH-250-140-12-121 në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Prokurori i Shtetit, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit” me numër prokurimi: PSH-250-140-12-121. Ky aktivitet prokurimi më datë: 04/07/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, pika 8.1, nënpika 1: Qarkullimi bankar vetëm për vitin 2012 dhe vitin 2013 duhet të jetë së paku 100.000.00 €. Dokumenti duhet të jetë i vërtetuar në njërin nga Bankat e Kosovë. Autoritet kontraktues mund të kërkoj dëshmi me të cilat do ta vërtetoj Kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomik, por nëse vendoset një kriter i tillë, duhet t’i referohet tre viteve të fundit, e jo dy vite siç keni kërkuar ju si Autoritet. Kufizimi nga tre vite në dy vite (2012/2013), zvogëlon numrin e ofertueseve. Autoriteti Kontraktues me kriterin e vënë, favorizon, gjegjësisht diskriminon disa Operator Ekonomik.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1, nënpika 2 dhe 3 kërkohet: 2.Lista e kontratave për furnizime me automjete të realizuara gjatë dy (2) viteve të fundit 2012/2013, së bashku me më së paku dy (2) kontrata të kopjuara, si dhe 3.Së paku dy (2) referenca nga autoritetet kontraktuese që ndërlidhen me realizimin e kontratave për furnizim me automjete gjatë dy (2) viteve të fundit 2012/2013. Referencat për punë të ngjashme të bashkangjitura me kontratë, duhet kërkuar për tre vitet e fundit. Kufizimi nga tre vite në dy vite (2012/2013), zvogëlon numrin e ofertueseve. Autoriteti Kontraktues me kriterin e vënë, favorizon, gjegjësisht diskriminon disa Operator Ekonomik.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi si dhe nenin Neni 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Udhëzimit Administrativ UA-02-2014 si dhe 23 Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

